



VENDIMI I PAPRANUESHËRISË

Data e miratimit: 8 prill 2011

Nr. i rastit: 2011-03

Afrim Mustafa

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 prill 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, Kryesues i Panelit
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Z. Francesco FLORIT, anëtar

Asistuar nga

Z. John J. RYAN, Zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, Zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, paraqitur në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Koncepti Llogaridhënës i EULEX-it i datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 3 shkurt 2011.

II. FAKTET

Parathënie

2. Faktet vijuese janë vendosur në bazë të vendimeve të Komisionit të Pavarur për Media (15 nëntor 2007) dhe Gjykatës Kushtetuese (15 tetor 2010).

3. Më 19 dhjetor të vitit 2000, Komisioni i Pavarur për Media (tash e tutje: "KPM") i ka lëshuar parashtruesit të ankesës një licencë për të operuar një radio stacion "Radio Zëri i Sharrit", për të transmetuar në komunën e Kaçanikut dhe Ferizajt nga një lokacion në Hanin e Elezit. Licenca ishte ndryshuar në bazë të një marrëveshje në mes të parashtruesit të ankesës dhe KPM-së më 21 korrik 2005.
4. Në vitin 2005, parashtruesi i ankesës kishte hasur në probleme me transmetuesin e tij dhe ai kishte filluar të transmetojë përkohësisht nga një lokacion tjetër, i cili nuk ishte përfshirë në kushtet për licencën e tij. Ai pohon se ai kishte njoftuar KPM-në për këtë veprim të përkohshëm.
5. Në fillim të nëntorit të vitit 2006, KPM-ja ishte njoftuar se parashtruesi i ankesës kishte lëvizur transmetuesin e tij dhe se ai ishte duke transmetuar nga një vend tjetër duke përdorur koordinata të frekuencave që nuk ishin të saktësuara në licencën e tij. Parashtruesit të ankesës i ishte kërkuar që të jep sqarime autoriteteve rreth ndryshimit të lokacionit dhe frekuencave. Ai njoftoj KPM-në se për shkak të forcës madhore ai ishte i detyruar për të operuar në një lokacion të ri. Ai argumentoi se ndryshimi i lokacionit ishte në përputhje me licencën e tij.
6. Nga një letër e datës 13 nëntor 2006, KPM-ja kishte njoftuar parashtruesin e ankesës se ai nuk ishte në përputhje me licencën e tij për radio dhe se ai duhej të zhvendoste veprimtarinë e tij në Hani Elezit brenda 5 (pesë) ditësh, siç është përcaktuar në licencë. Parashtruesi i ankesës nuk kishte vepruar sipas këtij urdhri.

Procedurat

7. Më 10 janar 2007, KPM-ja kishte njoftuar parashtruesin e ankesës se ai ishte duke shkelur kushtet e licencës së tij. KPM-ja i vuri një gjobë me kusht prej 1.500 €, e që ai do të duhej ta paguante vetëm në qoftë se ai nuk do të zhvendoste veprimtarinë e tij në zonën e licencuar dhe nëse ai do të kryente ndonjë tjetër shkelje të licencës brenda gjashtë muajve në vijim. Parashtruesi i ankesës nuk pranoi të nënshkruajë marrëveshjen dhe ai gjithashtu nuk pranoi të zhvendoste veprimtarinë e tij.
8. Më 6 prill 2007, Këshilli i KPM-së i vuri një gjobë parashtruesit të ankesës në shumën prej 1.500 euro për shkelje të afateve dhe kushteve të licencës. Përveç kësaj, parashtruesi i ankesës ishte urdhëruar të zhvendoste veprimtarinë e tij në lokacionin e licencuar brenda 20 ditësh.
9. Parashtruesi i ankesës kishte paraqitur ankesë kundër këtij vendimi. Më 3 gusht 2007, Bordi i Ankesave vërtetoi vendimin e Këshillit, dhe kështu vendimi mori formën përfundimtare.
10. Më 10 shtator 2007, parashtruesit të ankesës i ishte dhënë një mundësi tjetër për të respektuar kushtet e licencës së tij deri më datën

17 shtator 2007. Ai nuk pranoi që t'i dorëzohet ky vendim, nuk kishte paguar gjobën dhe nuk e kishte zhvendosur veprimtarinë e tij.

11. Më 16 tetor të vitit 2007, parashtruesi i ankesës kishte paraqitur një kërkesë tek Bordit i Ankesave për Media. Ai deklaroi se nuk ishte në gjendje të paguajë gjobën në atë kohë, por që do të bëjë këtë pasi ankesa e tij të shqyrtohet nga Gjykata Supreme. Ai gjithashtu deklaroi se nuk ka ndërmend të zhvendoste antenat dhe transmetuesit në lokacionin fillestar.
12. Më 15 nëntor 2007, KPM-ja ia kishte pezulluar licencën e radio stacionit për tre muaj duke iu referuar vendimit të saj të mëparshme të datës 6 prill 2007 (shih paragrafin 8 sipër) dhe për shkeljet e vazhdueshme të afateve dhe kushteve. Parashtruesi i ankesës ishte urdhëruar të rifilloj transmetimin nga lokacioni i licencuar në pajtim me kushtet e licencës pas skadimit të periudhës tre mujore. Për më tepër, aty thuhej se në qoftë se ai nuk vepruan në pajtim me vendimin, atëherë do t'i tërhiqej licenca dhe veprime të mëtejshme ligjore do të parashihen kundër tij. Më pas, Bordi i Ankesave vërtetoi këtë vendim.
13. Më 5 qershor 2008, KPM-ja kishte konfiskuar pajisjet e stacionit të radios të parashtruesit të ankesës mbi bazën e një urdhri përkatës të lëshuar më 4 qershor 2008. Parashtruesi i ankesës kishte paditur KPM-në para Gjykatës Komunale të Kaçanikut. Padia ishte hedhur poshtë nga gjykata dhe më pas ajo padi ishte shpallur e papranueshme nga një vendim i Gjykatës Supreme të datës 12 shkurt 2009.
14. Më 25 qershor 2009, mbylljen e këtij radio stacioni ishte debatuar në Kuvendin e Kosovës në lidhje me debatin për raportin vjetor të KPM-së. Ishte vendosur që Kuvendi mund vetëm të debatonte rreth çështjes, pasi KPM-ja kishte hartuar raportin e vet dhe rekomandimet lidhur me këtë çështje.
15. Më 20 korrik 2009, parashtruesi i ankesës kishte kërkuar një licencë të re operative për lokacionin e ri. Ai pohoi se nuk kishte marrë asnjë përgjigje rreth aplikacionit të tij.
16. Më 15 tetor 2010, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit të ankesës që rasti i tij të shqyrtohet nga gjykata, pasi kërkesa nuk ishte paraqitur brenda afatit kohor prej katër muajsh, siç përcaktohet në ligj.

III. ANKESAT

17. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 17 (2) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj, 1950).

18. Ai pohon se KPM-ja kishte marrë veprime arbitrare në lidhje me radio stacionin e tij dhe se kishte shkelur të drejtën e tij për zotërimin paqësor të pasurisë së tij, e cila ishte krijuar nëpërmjet punës dhe investimeve të tij vetanake.
19. Ai kërkon që të gjitha vendimet e lëshuara nga KPM-ja të shpallen të pavlefshme dhe të kthehen pajisjet e konfiskuara së bashku me një kompensim në të holla për dëmin që ai kishte pësuar si pasojë e konfiskimit të pajisjeve dhe mbylljes së radio stacionit.


IV. LIGJI

20. Para shqyrtimit të ankesës për bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të ankesës të përcaktuar me Rregulloren 29 të Procedurës së Punës.
21. Sipas Rregullores 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv.
22. Çështjet e ngritura në këtë ankesë kanë të bëjnë me një kontest midis parashtruesit të ankesës dhe KPM-së lidhur me respektimin e licencës për transmetim të lëshuar nga ai autoritet. Nuk është treguar apo as edhe argumentuar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në rastin e parashtruesit të ankesës.
23. Si pasojë, çështja që paraqitet në këtë ankesë nuk bie brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, që kufizohet në çështjet e caktuara që kanë të bëjnë me gjyqësinë, policinë dhe doganat.


PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri konstaton se nuk ka juridiksion për ta shqyrtuar këtë ankesë, dhe konstaton se ankesa është e pabazuar sa i përket Nenit 29 (d) të Rregullores së Punës së vet, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.


John J. RYAN
Senior Legal Officer




Antonio BALSAMO
Presiding Member